



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 122

Tiranë – E enjte, 25 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 443, datë 22.5.2017	Për bashkëfinancimin e shtesës së kontratës “Për ndërtimin e vijës bregdetare të Vlorës” 6357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 22.5.2017	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitin 2017..... 6357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 22.5.2017	Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë..... 6357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 22.5.2017	Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit..... 6368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 22.5.2017	Për shpërndarjen e fondit të investimeve për funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2017..... 6368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 22.5.2017	Për një ndryshim në vendim nr. 1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës”, të ndryshuar..... 6369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 22.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” 6370
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 22.5.2017	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Gelardina Prodani (Duçka) 6370

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 22.5.2017	Për lirim nga detyra.....	6370
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 22.5.2017	Për lirim nga detyra.....	6371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 22.5.2017	Për lirim nga detyra.....	6371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 22.5.2017	Për emërim në detyrë.....	6371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 22.5.2017	Për emërim në detyrë.....	6371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 22.5.2017	Për emërim në detyrë.....	6371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 22.5.2017	Për emërim në detyrë.....	6372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Tiranës.....	6372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Durrësit.....	6372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Fierit.....	6372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit.....	6372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Korçës.....	6373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Dibrës.....	6373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 22.5.2017	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Beratit.....	6373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 22.5.2017	Për lirim nga detyra.....	6373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 22.5.2017	Për emërim në detyrë.....	6373

**VENDIM****Nr. 443, datë 22.5.2017****PËR BASHKËFINANCIMIN E SHITESËS
SË KONTRATËS “PËR NDËRTIMIN E
VIJËS BREGDETARE TË VLORËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, si dhe në vijim të vendimit nr. 71, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian, për programin kombëtar për Shqipërinë, në kuadrin e komponentit IPA “Asistenca e Tranzicionit dhe Mbështetja Institucionale”, për vitin 2013, nënshkruar nga Koordinatori Kombëtar i fondeve IPA në datën 19.2.2014, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi, në vlerën 318 550 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, nga zëri “Kosto lokale”, i miratuar në buxhetin e vitit 2017 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, të përdoret për bashkëfinancimin e shtesës së kontratës së punimeve, me nr. 2015/360-660, datë 13.5.2015, “Për ndërtimin e vijës bregdetare të Vlorës”, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, me përfitues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

2. Pagesat për shtesën e kontratës së punimeve do të bëhen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bazë të kërkesës së Delegacionit të Bashkimit Evropian.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 444, datë 22.5.2017****PËR SIGURIMIN E JETËS SË
USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, QË DËRGOHEN NË
MISIONE USHTARAKE DHE STËRVITJE
JASHTË VENDIT, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me bashkimin e operatorëve ekonomikë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA”, sh.a., “SICRED”, sh.a. dhe “INSIG JETË”, sh.a., të bëjë sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitin 2017.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 445, datë 22.5.2017****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË
LIMITIT ORGANIK DHE PËRCAKTIMIN
E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE
PËR ÇDO GRADË NË GARDËN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2005,



“Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, dhe të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Gardës së Republikës së Shqipërisë është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Gardës së Republikës së Shqipërisë është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Funksionet korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë përcaktohen sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Numri i limitit organik të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë është 1 358 veta.

5. Zbatimi i kësaj strukture bëhet brenda tre muajve nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vendimi nr. 612, datë 11.6.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, organizimit, varësisë strukture dhe limitit organik të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



















**VENDIM****Nr. 446, datë 22.5.2017**

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË
PËRGJITHSHËM TË PERSONELIT TË
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 19, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit në organikë është 10 958 (dhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) punonjës.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 447, datë 22.5.2017**

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË
INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E
SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË DISA
NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE,
PËR VITIN 2017**

Në mbështetje pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 16, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të pikës 76, të udhëzimit nr. 8, datë 13.1.2017, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi për investime, për funksionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, miratuar në buxhetin e vitit 2017, në shumën 20 000 000 (njëzet milionë lekë), shpërndahet për blerje automjesh dhe pajisjesh zjarrfikëse, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, si organ qendror blerës, për kryerjen e prokurimit të fondit limit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si shumë e fondeve për secilën prej bashkive përfituese.

3. Fondet e papërdorura, të mbetura pas përfundimit të procesit të prokurimit dhe lidhjes së kontratave, sipas pikës 2, të këtij vendimi, rishpërndahen për bashkitë e tjera, me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përfituese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA NR. 1

**SHPËRNDARJA E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E SHËRBIMIT TË
MZSH-SË PËR 5 NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR BLERJE
AUTOMJETESH DHE PAJISJESH ZJARRFIKËSE**

Bashkitë	Emërtimi i investimit	Vlera
Shijak	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Divjakë	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Këlcyrë	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Ura Vajgurore	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Fushë Arëz	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Totali		20 000 000 lekë



VENDIM

Nr. 449, datë 22.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1240, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË POGRADEC, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë për Bashkinë Pogradec dhe heqjen nga lista që i bashkëlidhet vendimit nr. 1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të pronave me numër rendor 149 dhe 151, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror:				Identifikues: Altin Zhebro		Supervizor: Alqi Memaj		Aprovat: Mangelina Gane (Kryetare e Bashkisë)			
Bashkia / Komuna : Pogradec											
Fusha e përdorimit të Pronës: Administrate e Qarkut											
Nr. Rend.	A		B				C				
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhena të tjera (Shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
147				Zyra Qendrore e Gjendjes Civile Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Administratë	Prefektura Korçe	Zyra e Gjendjes Civile Pogradec	Ka dy ambiente në katin përde ne ndertesen e Bashkisë	
148				Zyrat e Administrimit të tokës bujq. Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Administratë	Qarku Korçe	Zyra e Adm. Tokës. Bujq Pogradec	Ka dy ambiente në katin e parë ne ndertesen e Bashkisë	
149				Zyra e Sekretarit të Deputetit Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre pritje	Deputeti I Zones	Deputeti I Zones nr. 85	Ka një ambient në katin e dytë ne ndertesen e Bashkisë	
150				Zyra e të Dërguarit të Prefektit Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre pritje	Prefektura Korçe	Nenprefekti Pogradec	Ka një ambient në katin e dytë ne ndertesen e Bashkisë	
151				Dhome Pritje e Deputetit për zonën Nr. 84. L. Nr. 2 "Rr. Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre Pritje	Deputeti I Zones	Deputeti I Zones nr. 84	Ka dy ambiente në katin e dytë ne ndertesen e Bashkisë dhe një wc	

**VENDIM****Nr. 450, datë 22.5.2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES
STUDENTORE PËR STUDENTËT E
SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIUMI
NË FUSHAT PRIORITARE DHE
STUDENTËT NË NEVOJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 13, e vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Afati për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për studentë të regjistruar në IAL-të publike përcaktohet për çdo vit, në urdhrin e ministrit që përcakton edhe planin e shpërndarjes së bursave për vitin akademik.”.

Faqe | 6370

2. Përgjashtimisht për vitin 2017, afati për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për studentë të regjistruar në IAL-të publike do të jetë data 30 maj 2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 451, datë 22.5.2017**

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ.
GELARDINA PRODANI (DUÇKA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Gelardina Prodan (Duçka), në masën 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 452, datë 22.5.2017****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e



Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Elona Gjebrea, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 453, datë 22.5.2017

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ervin Mete, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 454, datë 22.5.2017

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Eridian Salianji, zëvendësministër i Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 455, datë 22.5.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Roven Voda emërohet zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 456, datë 22.5.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Irena Beqiraj emërohet zëvendësministër i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 457, datë 22.5.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Etilda Salu Gjonaj emërohet zëvendësministër i Drejtësisë.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 458, datë 22.5.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Mira Kapisyzi emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 459, datë 22.5.2017

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Admir Abrija emërohet prefekt i Qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 460, datë 22.5.2017

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË Durrësit**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Emiljan Jani emërohet prefekt i Qarkut të Durrësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 461, datë 22.5.2017

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Vasil Bregu emërohet prefekt i Qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 462, datë 22.5.2017

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ardit Demiri emërohet prefekt i Qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 463, datë 22.5.2017****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Pandi Papando emërohet prefekt i Qarkut të Korçës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 464, datë 22.5.2017****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe, të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ardit Kaja emërohet prefekt i Qarkut të Dibrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 465, datë 22.5.2017****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Valbona Zylyftari emërohet prefekt i Qarkut të Beratit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 466, datë 22.5.2017****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Redi Shtino, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 467, datë 22.5.2017****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gerti Janaqi emërohet zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë